

në tre drejtime – drejt lagjes *Përroi/Potok*, drejt kafe-restorantit *Rainbow* dhe drejt ambulancës. Por, Nahiti dhe Bashkimi rastisën të ishin mu para autobлиндave policore. Policët shtënë dhe i vranë që të dy në vend. Policia serbe i ka varrosur Nahitin dhe Bashkimin pranë gropës me bërlllok [prapa varrezave myslimane] në Rahovec/Orahovac. Në muajin maj të vitit 2007, u bë zhvarrimi i mbetjeve mortore të Nahitit dhe Bashkimit, ndërkaq në muajin gusht të të njëjtit vit edhe identifikimi i tyre, në bazë të analizës së ADN-së. Në datën 20.08.2007, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Bashkimit në varrezat myslimane. Varrimi i mbetjeve mortore të Nahitit u bë më 15.10.2007, po ashtu, në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.N, FDH-852; deklarata N.N, FDH-856; deklarata N.V, FDH-880; deklarata N.N, FDH-882; deklarata M.S, FDH-969; deklarata S.S, FDH-20093; V.B, FDH-20095; deklarata B.H, FDH-34332; deklarata B.S, FDH-33628; LBI, *Preliminar..*, FDH-3631; OMPE, *Mbetjet..*, FDH-15297.

Hanumshahe (Xhemajli)

Eminhazeri

(3.10.1949, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, shtatë fëmijë)

Policia serbe e ka vendosur kontrollin mbi **Rahovecin/Orahovac**, në pasditen e datës 19.07.1998. Ditën e hënë, më **20.07.1998**, rreth orës 7:00, Hanumshahja, bashkëshorti dhe fëmijët e tyre u strehuan në Teqenë, ku mbrojtjen e kërkonin edhe shumë shqiptarë të tjerë. Rreth orës 10:00, policia serbe urdhëroi që njerëz të dilnin nga Teqeja. Hanumshahja dhe familjarët e saj u nisën në drejtim të Malishevës/Mališevo. Kolona e civilëve i numëronte afro 100 njerëz. Kur arritën të ambulanca, dikush nga grupi i policëve serbë ka shtënë drejt kolonës duke e qëlluar Hanumshahen. Gjetei vdekjen në vend. Vajza e saj Elizabeta, me ndihmën e një gruaje, e ka bartur trupin e nënës në fushën më të afërt. Po atë ditë, ushtarë të UÇK-së e kanë bartur trupin e Hanumshahes në lagjen *Përroi i Antes/Antin potok*. Disa ditë më vonë, familjarët u kthyen në qytet dhe, më 6.08.1998, pasi

e morën lejen e pushtetit serb, e varrosën Hanumshahen në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata E.E, FDH-33629; KKMKRF, *Personat..*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri..*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički..*, III, 98, 911; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00614, FDH-35527.

Ferdeze (Sadik Selan Cena)

Mullaabazi

(1931, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, pesë fëmijë)

Myzaqete (Avdullah Duraku)

Haxhiymeri

(1.01.1954, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, pesë fëmijë)

Ditën e hënë [**20.07.1998**] në orët e hershme të mëngjesit, Ferdeze Mullaabazi me djalin dhe vajzën Ibadeten shkuan në Teqenë e Qytetit [Rahovec/Orahovac], për tu strehuar dhe mbrojtur nga policia serbe. Në mesin e qytetarëve të shumtë ishin edhe Myzaqetja, e cila në Teqenë e Qytetit u strehua me bashkëshortin Abdullahun dhe fëmijët e tyre. Ferdezja dhe Myzaqetja ishin në përbërje të grupit të qytetarëve, i cili pas urdhrit policor për tu larguar nga Teqeja, u nis drejt *Mëhallës Përroi/Potok*, me qëllim shkuarjen dhe strehimin në Malishevë/Mališevo. Te vendi i quajtur *Varrezat Serbe/Srpsko groblje [Rahovec/Orahovac]*, policia ka hapur zjarr mbi grupin e qytetarëve. Myzaqetja dhe Ferdezja u vranë në vend, përderisa një numër i madh qytetarësh u plagosën, në mesin e tyre edhe djali i Myzaqetes, Osmani. Ferdezen e kanë varrosur vajza Ibadetja dhe Bajram Isma, në vendin e quajtur *Lugshtaj*. Djali i Myzaqetes, Lulëzimi, e ka varrosur të ëmën në afërsi të udhëkryqit të rrugës Rahovec/Orahovac – Malishevë/Mališevo. Në datën 20.12.1998, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Myzaqetes në varrezat myslimane. Forcat serbe i kanë zhvarrosur ditën e pacaktuar mbetjet mortore të Ferdezës dhe i kanë çuar në drejtim të panjohur. Rasti i saj është evidentuar në listën e të zhdukurve